



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE DURRËS



NOTER FREDERIK J. TENGU
ADRESA LAGJIA NR.1, JOSIF BUDO,
NR.98, 18/271
TEL: 682038259

VERTETIM NENSHKRIMI

(STATUTI)

Nr. repertori: 124

Kavaje më 22/01/2021

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"



V2021010850005550874

STATUTI I SHOQERISE**“BERILL EXIM” SH. P. K.**

Ortaku i Vetem: BERNAT BALIKO atesia Attila, i datelindjes 04.06.1998, lindur ne Hungari dhe banues ne Hungari, me pasaporte te shtetit te Hungarise me nr.BJ1853777, me vullnet të lirë e të plotë mbeshetur ne:
Ligjin Nr. 9901 datë 14. 04. 2008, “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, Ligjin Nr. 9723 date 03. 05. 2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, harton .statutin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar me emertimin “.BERILL EXIM” sh.p.k.”

KREU I**NENI 1**
KRIJIMI

Shoqëria është person juridik i se drejtës shqiptare, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. (SHPK)

NENI 2**PERSONALITETI JURIDIK**

Shoqëria fiton personalitetin juridik nga data e regjistrimit te saj në QKR (Qendra Kombetare e Rregjistrimit), në përputhje me kushtet e procedurat e parashikuara ne ligjin nr.9723 dt.3.5.2007.

Shoqëria qe ne momenti qe ka fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

NENI 3**SELIA**

Shoqëria e ka selinë në Golem Kryemedhenj, ne pasurine me nr.116/66+2-16, zona kadastrale 2291.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hap zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, me vendim të Ortakut të Vetëm.

Keto organizohen dhe administrohen me vete dhe ushtrojne veprimtari me pale te treta, ne emer te shoqerise.

Nese dega ose zyra e perfaqsimi do te krijoje nje faqe interneti, ato do te publikojne numrin unik te identifikimit te shoqerise ne kete faqe interneti.

NENI 4**OBJEKTI KRYESOR I VEPRIMTARISE**

Shoqeria ka per OBJEKT aktivitetin privat:

- Ne fushen e import-eksporti

Ne fushen e dhenies me qira te pasurive te luajtshme dhe te paluajtshme ne pergjithesi, administrimi i tyre

Ndertime dhe punime perfundimtare, punime te tjera perfundimtare

Tregtia me pakice jashte njesive tregtare

Tregtia me pakice me korrespondence (telefon, katalogeve, internet etj)

NENI 5

KOHEZGJATJA

Shoqëria do të zhvilloj aktivitetin e saj për një periudhë kohore të paktuar.
Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë me vendim të ortakut të vetëm për motive të bazuara në ligj.

KREU II
KAPITALI
NENI 6

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 leke i barabartë në 1 kuotë .

Kapitali i mësipërm është i nënshkruar dhe derdhur teresisht nga ortaku i vetëm i shoqërisë, **Bernat Baliko**.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme dhe as me kontribute në shërbime.

Ortaku përgjigjet për humbjet e shoqërisë përkundërt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

NENI 7ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga organi kompetent të një eksperti të autorizuar për këto kontribute.

Zvogëlimi i kapitalit realizohet me vendim të Ortakut të Vetëm në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit. Projekti i zvogëlimit të kapitalit u komunikohet ekspertëve kontabël të autorizuar, në rast se ka të tillë, të paktën 45 (dyzet e pesë) ditë përpara datës së mbledhjes së Ortakut të Vetëm të thirrur për të marrë vendimin rreth këtij projekti.

NENI 8TRANSFERIMI I KAPITALIT

Pjesët e kapitalit themeltar mund t'u transferohen personave të tretë, që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm me miratimin e Ortakut të Vetëm.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie. Ato janë lirisht të transferueshme edhe në rast ndarjeje pasurore mes bashkëshortëve.

Gjithashtu janë lirisht të transferueshme ndërmjet bashkëshortëve, si dhe ndërmjet paraardhësve dhe pasardhësve.

Neni 9

Me vendimin e ortakut të vetëm shoqëria mund të shtojë ortake të rinj ku përqindja e kuotave të tyre do të jetë në ekuivalencë me kontributin e derdhur. I cili do të jetë sipas vendimit të ortakut të vetëm, duke u njoftuar kjo për regjistrim në QKR.

Kuotat mund të pjestohen për shkak të kalimit të tyre

KREU IIIORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESENENI 10ORGANI VENDIMMARRES

Ortaku i Vetëm është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë, që miraton dhe vendos për çeshtjet:

- Percaktimin e politikave tregëtare të shoqërisë,
- ndryshimin e statutit,
- Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve,
- Emerimin dhe shkarkimin e likujduesve dhe të eksperteve kontabel të autorizuar.
- mbikqyrjen e politikave tregëtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen dhe miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë.
- perfaqsimin e shoqërisë në gjykate dhe në procedimet e tjera ndaj administratoreve.
- Vendos për zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit.
- riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë,

Ortaku i vetëm brenda një afati prej gjashtë muajsh, duke filluar nga data e mbylljes së vitit financiar, miraton raportin e administrimit, inventarin, bilancin dhe llogaritë vjetore, të hartuara nga administratorët.

Ai mund të përfaqësohet edhe nga një tjetër person.

Neni 11

Te gjitha vendimet e marra nga ortaku I vetëm regjistrohen në një regjister të vendimeve, të dhenat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Vendimet e pa regjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme.

NENI 12

ADMINISTRIMI

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim të Ortakut të Vetëm të Shoqërisë, për një periudhë prej 5 vitesh, me të drejtë ripërteritje, I cili mund të zgjidhet dhe jashtë ortakeve të shoqërisë.

Administrator i shoqërisë është emruar **Z.Bernat Baliko** për një periudhë kohe 5 vjeçare që nga momenti i emerimit, me të drejtë riemerimi.

Tagrat e perfaqsimit të administratorit dhe cdo ndryshim I tij njoftohen për regjistrim pranë QKR.

NENI 13

KOMPETENCAT

Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave, që ligji ia jep shprehimisht ortakut të shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve, që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve, kur ajo provon se të tretët e dinin, që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Klauzolat e këtij statusi, që kufizojnë kompetencat e administratorit, të cilat rrjedhin nga ky nen, duhet të respektohen nga të tretët.

Administratorit nuk i lejohet të marrë hua të shoqëria, të japë pëlqimin në emër të saj për paradhënie si dhe të bëhet dorëzënës apo të garantojë në emër të saj angazhimet ndaj të tretëve. Në rast të kundërt kontrata është e pavlefshme.

 NENI 14

PERGJEGJESITE

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statusit, apo për fajë të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e mareveshjeve të pamiratuara nga ortaku i vetëm që i sjellin dem shqerise, i ngarkohen administratorit që ka bërë merreveshjen, për të perballuar ato në mënyrë individuale .

Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator ata përgjigjen ndaj shoqerise ne menyre solidare.

Administratori ka barrën e provës për të vertetuar krytjen e detyrave të tij në mënyrë të rregullt e sipas standarteve të kerkuara.

Perveç padise për shlyerjen e demit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortaku ka të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.

Ortaku ka të drejtë të ndjeke në rrugë ligjore shlyerjen e plote të demit, që i është shkaktuar shoqerise, përfshire edhe demshperblimin financiar, nëse është e nevojshme.

Neni 15

Administratori ka të drejtë e detyrohet :

-Të kryejë të gjithë veprimet e administrimit të veprimtarisë tregëtare të shoqerise, duke zbatuar politikën tregëtare të përcaktuar nga Asambleja e përgjithshme (ortaku i vetëm.)

-Të përfaqësojë shoqerine tregëtare.

-Kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumentave dhe të librave kontabel të shoqerise.

-Përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve ia paraqit këto akte ortakut të vetëm (ortakeve) për shqyrtim.

-Kryen regjistrimet dhe i dërgon të dhënat e detyrueshme të shoqerise, pranë QKR, siç parashikohen në ligjin për Qendren Kombëtare të Regjistrimit.

-Ti propozojë ortakut të vetëm numrin e punonjësve të shoqerise , pagat dhe emerimin e shkarkimin e tyre.

-Shqyrton oferta të ndryshme dhe përgatit kërkesa të cilat ia paraqet Ortakut të vetëm (ortakeve) për miratim.

-Ndjek probleme të shoqerise në marrëdhënie me persona fizikë e juridikë ose cakton ndonjë prej personelit për trajtimin e këtyre problemeve.

-Ti propozojë ortakut të vetëm për miratim strukturën e aparatit të shoqerise dhe krijimin e organeve tjera të nevojshme për realizimin e objektivave të shoqerise.

NENI 16**VITI FINANCIAR**

Viti financiar i Shoqerise fillon më 22 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor.

Perjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqerise në Qendren Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

NENI 17**BILANCI I SHOQERISE DHE DIVIDENTET**

Brenda 6 (gjashtë) muajsh nga mbyllja e vitit financiar mbledhja e ortakut të vetëm, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.




Ne fund të cdo periudhe ushtrimore të aktivitetit administrativ ndjek nxjerrjen e bilancit kontabel të shoqërisë nga ekspertët kontabel I autorizuar, I cili kontrollon gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë.

Mbledhja e Ortakut të Vetem vendos rreth shpërndarjes së dividendit, pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm financiar sic edhe parashikohet nga ligji.

Shoqëria mund të shpërndajë fitime ortakëve, (ortakut të vetem), vetëm nëse pas pagimit të dividendit :

- Aktivitetet e shoqërisë mbulojnë interesat detyrimorë të saj,
- nëse Shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që behen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

Administratori (administratoreti) leshojnë një certificate të aftësisë paguese që konfirmon se shpërndarja e dividendeve përmbush kërkesat e paragrafit të mesiperm.

NENI 18

EKSPERTET

Ekspertët ka për detyrë të kontrollojnë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë, atë gjithë vjetor dhe atë në lidhje me kontrollin periodik të ushtruar prej tij, për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e Ortakut të Vetem.

NENI 19

Bilanci Kontabel vjetor miratohet mbi bazën e vendimit me shkrim nga Ortaku i vetem, i cili jo vetëm që dokumenton miratimin e tyre por vendos në lidhje me disponibilitetin e fondeve ligjore sipas nevojave të zhvillimit të mëtejshëm të shoqërisë dhe garantimin e veprimtarisë së rregullt të saj, duke pasur parasysh fondin e akumulimit, krijimin e fondit të veçantë etj.

NENI 20

Te ardhurat neto (dividenti) që mbeten pas veçimit të fondeve ligjore të mesipërme dhe të atyre për shlyerjen e çdo detyrimi fiskal apo likuidimit të pagesave ndaj të tregëve, i mbështet dhe i kalon në pronësi, Ortakut të vetem të shoqërisë.

PRISHJA DHE LIKUJDIMI I SHOQËRISË

NENI 21

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në cdo kohë dhe për çfarëdo shkak, edhe para plotësimit të afatit për të cilin është krijuar sic mund të jenë:

Humbja e kapitalit ose pamundësia e vazhdimit të mëtejshëm të veprimtarisë së saj.

Në një nga mënyrat e parashikuara nga ligji "Për Falimentimin e Shoqërive Tregtare" Kur plotësohet afati i caktuar për ushtrimin e veprimtarisë tregtare.

Në këtë rast Ortaku i Vetem merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtesë " Shoqëri në likuidim ".

Prishja e shoqërisë tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit të emërtuar nga Asambleja e shoqërisë (ose Ortaku i Vetem), bazuar në nenin 191 pikë 2, të ligjit 9901 dt.14.04.2008.

Nëse Ortaku i Vetem nuk merr një vendim për emerimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, cdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

NENI 22

Likuiduesi merr persiper te drejtat dhe detyrimet e administratoreve nga data e emerimit te tij. Nese shoqeria emerohet me shume se nje likuidues, pervecse kur akti i emerimit parashikon se ata veprojne vecmas njeri-tjetrit, likuiduesit ushtrojne bashkerisht te drejtat e detyrimet sipas ketij ligji. Likuiduesit mund te autorizojne njerin prej tyre te kryejne veprime te nje kategorie te posacme. Kufizimet e tagrave te likuiduesve u kundrejtohen te treteve, ne perputhje me percaktimet e ligjit. Likuiduesi u nenshtrohet mbikeqyrjes se ortakut dhe administratorit.

NENI 23

Afati i emerimit te likuiduesit , publikohet sipas kushteve qe parashikon ligji perkates duke specifikuar dhe dokumentat qe duhen depozituar ne Aneksin e QKR.

NENI 24

Likuiduesi eshte i detyruar qe te jete i vemendshem dhe korrekt, si per realizimin e te drejtave per subjektet ndaj te cileve shoqeria eshte kreditore dhe per ekzekutimin e detyrimeve debive qe shoqeria ka ndaj shtetit, shtetasve te vecante apo personave fizik apo juridik vendas apo te huaj.

Te drejtat e detyrimet e likuiduesit

1. Detyra e likuiduesve eshte mbyllja e te gjitha veprimeve te shoqerise, mbledhja e kredive te paarketuara dhe e kontributeve te pashlyera, shitja e pasurive te shoqerise dhe shlyerja e kreditoreve duke respektuar radhen e referimit, sipas nenit 605 te Kodit Civil.
2. Likuiduesi mund te kryejte edhe veprime te reja tregtare, per mbylljen e nje veprimi te paperfunduar.
3. Nese, ne baze te padive te ngritura nga kreditoret, likuiduesit verejne se pasuria e shoqerise tregtare, perfshire kontributet e pashlyera, nuk eshte e mjaftueshme per pagesen e ketyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojne proceduren e likuidimit e t'i kerkojne gjykates perkatese nisjen e procedurave te falimentimit. Likuiduesi pergatit nje bilanc te gjendjes se shoqerise ne castin e hapjes se likuidimit dhe nje bilanc perfundimtar ne castin e mbylljes se ketyre procedurave. Nese procedura e likuidimit zgjat me shume se nje vit, likuiduesi pergatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore te shoqerise. Bilancet miratohen nga asambleja e pergjithshme. (Ortaku i Vetem)

NENI 25*Perfundimi i Likuidimit*

Pas shperndarjes se aktiveve te mbetura, likuiduesi e njofton Qendren Kombetare te Regjistrimit per perfundimin e likuidimit dhe kerkon c' regjistrimin e shoqerise, ne perputhje me seksionin V te ligjit nr.9723, date 3.5.2007 'Per Qendren Kombetare te Regjistrimit'

NENI 26**BASHKIMI DHE NDARJA**

Shoqeria me ane te bashkimit, mund t'i kaloje trashegimine e saj nje shoqerie ekzistuese ose nje shoqerie te re qe ajo themelon.

Shoqeria gjithashtu me ane te ndarjes mund t'i kaloje trashegimnine e saj disa shoqerive te reja.

Ortaku i vetem i shoqerise, qe ben kafimin e trashegimise se saj ne kuadrin e operacioneve te permendura me lart, perfiton pjese te kapitalit themeltar nga shoqeria ose shoqerite perfituese dhe sipas rastit nje kompesim me para, vlere e te cilit nuk

mund të kalojë 10% (per qind) të vlerës nominale të pjesëve të kapitalit themeltar të dhëna.

Operacionet e permendura më lart mund të realizohen ndërmjet shoqërive të formave të ndryshme.

Bashkimi ose ndarja sjell prishjen pa likuidim të shoqërise, që zhduket, dhe kalimin e plote të trashëgimisë në datën e realizimit përfundimtar të operacionit. Bashkimi ose ndarja sjell njëkohësisht për ortakët e shoqërive, që zhduken marrjen e cilesisë së ortakëve të shoqërive përfituese sipas kushteve të përcaktuara në kontratën e bashkimit ose ndarjes.

NENI 27

BAZA LIGJORE

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plote me këtë akt dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

NENI 28

MOSMARREVESHJET

Për mosmarreveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarreveshje që mund të lindë midis Shoqërise dhe të tjerëve, do të jetë kompetente Gjykata e rrethit gjyqësor Kavaje.

NENI 29

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Per sa nuk është e parashikuar në këtë statut, do të bëhet referim ligjit Nr.9901 dt.14.04.2008 " Per tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare", si dhe legjislacionit koherent. Ky Statut u redaktua në 4 ekzemplare me vlera të njëjta juridike dhe , nënshkruhet me vullnetin e lirë nga ortaku themelues.

Kavaje me datë 22.01.2021

ORTAKU I VETEM

Bekurat Balibë

Balibë

Perlektya

Sander Kocës

M. Jeli

[Signature]

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE DURRËS
NOTER FREDERIK J. TENGU



V2021010850005550874

TAKSA E PULLES
LIRU/DUA NOTER
FREDERIK TENGU

DATE 22/01/2021
NR REP 124

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 22.01.2021 para meje Noter FREDERIK J. TENGU, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore DURRËS, me zyrë në adresën Kavaje, LAGJIA NR.1, JOSIF BUDO, NR.98, 18/271, u paraqit personalisht:

NËNSHKRUES:

Bernat Baliko, atësia Attila, shtetas Hungarez, lindur në Hungari dhe banues në Hungari, lindur më 04/06/1998, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me pasaporte te shtetit te Hungarise nr.BJ1853777 , .

Madhore e me zotesi te plote juridike per te vepruar i cili ne prezencen time noterit deklaroi se per sa me siper **eshte Statut i Shoqerise "BERILL EXIM" sh.p.k** i redaktuar me vullnetin e lire e te plote te tij dhe qe e ka nenshkruar personalisht ne pranine time noterit, ne kete zyre noterie.

Akti ju perkthye ortakut te vetem te Shoqerise ne gjuhen e tij hungarisht nga shtetasi **SANDOR DR. KOCZKAS** i biri i Sandor, i dt.26.01.1963, lindur ne Nyiregyhaza Hungari dhe banues ne Hungari, identifikuar me karte identiteti te shtetit te Hungarise me nr.556586PA, njohur dhe pranuar nga shtetasi Bernat Baliko, i cili deklaroi se e ka perkthyer identik aktin e mesiperm dhe ka nenshkruar ne akt me ate cilesi ne prani te pales dhe meje noterit ne kete zyre noterie, per te cilen ortakut i Shoqerise deklaroi se e kuptoi dhe ishte dakort me sa me siper.

Unë Noteri pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin dhe vullnetin e tyre për sa me siper..

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noteri deklaroi se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER

FREDERIK J. TENGU